

VENDIM
Nr. 843, datë 28.10.2020

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “RRUGA
LIDHËSE E APOLONISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rruga lidhëse e Apolonisë”.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë “arë”, me vlerë 3 620 740 (tre milionë e gjashtëqind e njëzet mijë e shtatëqind e dyzet) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 620 740 (tre milionë e gjashtëqind e njëzet mijë e shtatëqind e dyzet) lekësh, të përballohet nga fondet e miratuara për Autoritetin Rrugor Shqiptar, për vitin 2020.
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
 6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
 9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
 10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar e të bëjnë kalimin e pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Fier, si dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lista e pronarëve ku pasuritë e tyre preken nga projekti “Rruga Lidhëse e Apolonisë”
Për tokën arë çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, datë 3.2.2016

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Nr. i pasurisë	Sip. totale	Lloji i pasurisë	Shpronësim	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	SHËNIME
								Sip. (m ²)			
1	Marie	Miço	Lako	3015	102/2	3214	are	97	269	26,093	Konf. ZVRPP
2	Ramadan	Myslim	Idrizi	3015	102/12	15225	are	371	269	99,799	Konf. ZVRPP
3	Ramadan	Hamdi	Cane	3015	102/13	3389	are	143	269	38,467	Konf. ZVRPP
4	Sotir	Thoma	Silo	3015	102/14	3002	are	136	269	36,584	Konf. ZVRPP
5	Vasillaq	Thoma	Silo	3015	102/15	2591	are	121	269	32,549	Konf. ZVRPP
6	Dhori	Llaqi	Lako	3015	102/16	10255	are	149	269	40,081	Konf. ZVRPP
7	Tahir	Myslim	Idrizi	3015	107/1	21951	are	483	269	129,927	Konf. ZVRPP
8	Luigj	Kole	Bardhi	3015	107/2	16875	are	258	269	69,402	Konf. ZVRPP
9	Koli	Nasi	Rushe	3015	101/4	11497	are	2	269	538	Konf. ZVRPP
10	Rrapi	Todi	Bufi	3015	101/3	4279	are	10	269	2,690	Konf. ZVRPP
11	Liu	Gola	Fodulli	3015	101/2	3231	are	41	269	11,029	Konf. ZVRPP
12	Koli	Nasi	Rushe	3015	101/1	11497	are	145	269	39,005	Konf. ZVRPP
13	Vasil	Gola	Fodulli	3015	106/2	2315	are	410	269	110,290	Konf. ZVRPP
14	Gori	Lio	Fodulli	3015	106/1	5000	are	538	269	144,722	Konf. ZVRPP
15	Vasil	Lili	Cuni	3015	100/1	4929	are	216	269	58,104	Konf. ZVRPP
16	Pandi	Kristo	Hila	3015	99/1	16388	are	4715	269	1,268,335	Konf. ZVRPP
17	Tasi	Sotir	Dimo	3015	97/1	4143	are	1602	269	430,938	Konf. ZVRPP
18	Gaqi	Ndoni	Lako	3015	73/5	4141	are	1483	269	398,927	Konf. ZVRPP
19	Stavri	Ndoni	Lako	3015	73/4	4123	are	138	269	37,122	Konf. ZVRPP
20	Sokrat	Pilo	Samarxhiu	3015	77/2	6000	are	689	269	185,341	Konf. ZVRPP
21	Miço	Llazi	Doko	3015	76/1	7638	are	965	269	259,585	Konf. ZVRPP
22	Daniel	Jani	Furxhiu	3015	76/2	5400	are	603	269	162,207	Konf. ZVRPP
23	Dhimitraq	Luci	Xherro	3015	76/3	10900	are	66	269	17,754	Konf. ZVRPP
24	Pilo	Lili	Cuni	3015	70/10	7740	are	29	269	7,801	Konf. ZVRPP
25	Sokrat	Gola	Fodulli	3015	70/11	615	are	50	269	13,450	Konf. ZVRPP
Shuma										3,620,740	